


CASINO SCHAANWALD

VETËPËRGJE- GJËSI DHE DISIPLINË NË LOJRAT E FATIT

Informacion mbi orientimin
kundër vartësisë nga lojrat e
fatit dhe mbi kontrollin e
vetëpërmbajtjes gjatë lojës.

Casino Schaanwald

Vorarlbergerstrasse 210
9486 Schaanwald
Liechtenstein
Tel. +423 238 27 77
meldungen@das-casino.li
www.das-casino.li

INFORMACIONE

lidhur me rreziqet e lojës

Kazinoja Schaanwald ka për qëllim që t'i ofrojë klientëve të saj një atmosferë të këndshme, duke i garantuar një lojë të ekuilibruar. Loja në Kazinonë Schaanwald duhet të jetë pjesë e këndshme e kohës së lirë dhe kontribuese e pushimit.

Kazinoja Schaanwald nuk dëshiron kurrësesi t'i shtyjë klientët drejt lojës së detyruar. Në këtë rast loja nuk është më një eksperiencë pozitive, por shkakton një problem të thellë. Kjo vlen jo vetëm për lojtarët dhe familjarët e tyre, por edhe për mysafirët e tjerë të kazinosë.

Me këto informacione dëshirojmë të sqarojmë se jo të gjithë vizitorët e lidhin qëndrimin e tyre në lojrat e kazinosë me një tension pozitiv dhe të ekuilibruar.

ÇFARË ËSHTË »VARTËSIA NGA LOJA«?

Flasim për vartësi nga loja në atë rast kur dëshira për të luajtur kthehet në mani, në një instikt për të zotëruar gjithçka. Në këtë mënyrë jo vetëm që humbitet shumë kohë e para, por humbet edhe besimi vetjak dhe autostima. Aspekte të tjera të jetës sikurse familja dhe puna kalojnë në plan të dytë ose lihen pas dore gjithmonë e më shumë. Në shumicën e rasteve ky është një proces i gjatë dhe pikërisht këtu qëndron ndërlikimi.

ÇFARË MUND TË BËNI?

Cilat janë mundësitë që keni në dispozicion kur lojën në kazino e përjetoni në mënyrë problematike?

- Kur vizitoni kazinonë vendosini një kufi importit të parave që do të përdorni.
- Mos merrni me vete më tepër para sesa importi i vendosur.
- Merrni me vete shoqërues sikurse miq ose familjarë.
- Vendosni më parë me cilën fitore dëshironi ta mbyllni lojën tuaj.
- Vendosni më parë se sa mund të jetë kufiri i sasisë së humbjes në lojë.
- Ju keni mundësinë të caktoni vetë bllokimin automatik të lojës.

PYETËSOR VETËVLERËSIMI

*mbi rrezikun e vartësisë**

Këto njëzetë pyetje duhet t'ju ndihmojnë të analizoni vetëpërbajtjen tuaj gjatë lojës. Nëse në fund të pyetësorit do keni dhënë përgjigjen «Po» tek të paktën gjashtë pyetje, atëherë duhet të reflektoni mbi marrëdhënien tuaj me lojën.

1. Nuk keni kryer angazhimet e ditës e të punës për shkak të lojës?
 PO **JO**
2. Loja ju ka shkaktuar humor të keq në shtëpi?
 PO **JO**
3. Reputacioni juaj është prekur për keq si pasojë e lojës?
 PO **JO**
4. A keni ndonjëherë vrarje ndërgjegje pas lojës?
 PO **JO**
5. A ju ka ndodhur të luani me qëllim që paratë e fituara t'i përdorni për të shlyer borxhet apo për të zgjidhur probleme të tjera financiare?
 PO **JO**
6. Projektet tuaja mbi të ardhmen dhe efizenca juaj kanë pësuar kufizime për shkak të lojës?
 PO **JO**
7. Dëshironi të luani për të fituar çdo herë që humbisni në lojë?
 PO **JO**
8. Pas çdo fitore në lojë, a e ndjeni të fortë instiktin për të vazhduar lojën me qëllim që të fitoni gjithmonë e më shumë?
 PO **JO**
9. A keni luajtur shpesh me frangat tuaja të fundit?
 PO **JO**
10. A keni marrë para hua deri më sot për të financuar lojën?
 PO **JO**

* Ky pyetësor vetëvlerësimi mbi rrezikun e vartësisë nga loja është hartuar nga Gamblers Anonymous (GA), organizata më e madhe e ndihmës personale për vartësit nga lojrat e fatit.

11. A keni dhënë ndonjëherë pjesë të pasurisë suaj për të luajtur?
 PO **JO**
12. Përdorni me ngurrim «Para të lojës» për shpenzime ditore?
 PO **JO**
13. A ju ka ndodhur të lini pas dore mirëqenien tuaj dhe të familjes suaj për shkak të lojës?
 PO **JO**
14. A ju ka ndodhur ndonjëherë të luani më gjatë sesa dëshironit?
 PO **JO**
15. A keni dëshiruar ndonjëherë të harronit shqetësimet dhe mërzitjet përmes lojës?
 PO **JO**
16. A e keni financuar ndonjëherë në mënyrë të jashtëligjshme lojën apo ju ka shkuar ndër mend një mundësi e tillë?
 PO **JO**
17. A ju ka ndodhur të keni shqetësime me gjumin për shkak të lojës?
 PO **JO**
18. A ju lind dëshira për të luajtur pas konflikteve, zënkave e zhgënjimeve?
 PO **JO**
19. A ju lind dëshira për të luajtur disa orë «për të festuar», në rast gëzimesh në jetën tuaj?
 PO **JO**
20. A ju ka shkuar ndonjëherë ndër mend që përmes lojës po rrezikoni ekzistencën tuaj?
 PO **JO**

VARTËSIA NGA LOJA NUK ËSHTË SHAKA!

Drejtojuni personelit tonë të specializuar. Do të informoheni në mënyrë kompetente mbi mundësinë për të marrë ndihmën e duhur.

VARTËSIA NGA LOJA NDAHET NË TRE FAZA TË PËRCAKTUARA QARTAZI:

Faza e Parë

FAZA E AVENTURËS OSE E FITORES

Gjatë kësaj faze lojtarët shpesh fitojnë importe të larta. Një përvojë e tillë mund të krijojë iluzionin se në vend të fatit, fitorja vjen si rezultat i veprimeve vetjake. Në mënyrë të paevitueshme fillojnë të shfaqen humbjet si rezultat i shkaqeve të jashtme dhe që në shumicën e rasteve paraqiten të maskuara. Situata bëhet gjithmonë e më shqetësuese kur lojtarët shpenzojnë vazhdimisht shumë para, ose kur marrin para hua për të vazhduar lojën. Gjithë paratë e marra hua kanë si qëllim të vetëm mundësinë e vazhimit të lojës.

Faza e Dytë

FAZA E HUMBJES

Hapi që vijon është kur lojtarët luajnë me paratë e marra hua. Këto huazime bëhen gjithmonë e më shumë fshehtëzi. Në përgjithësi, gjatë kësaj faze, fillon një distancim i lehtë nga familja dhe rrethi miqësor. Në këtë mënyrë i hapet rruga izolimit. Lojtarët mbeten të bindur se herët a vonë do mund ta kenë sërish nën kontroll situatën. «Sapo të mos kem më borxhe do të pushoj së luajturi» është një shprehje tipike kur arrihet në këtë pikë.

Faza e Tretë

FAZA E DËSHPËRIMIT

Në fund, loja të han gjithë ditën dhe të kontrollojë jetën. Si pasojë ndodh humbja e marrëdhënieve, e punës dhe e njohjes. Kalimi nga niveli problematik tek vartësia nga loja është i rrjedhshëm. Gjithësesi nuk është e thënë që pas çdo faze kalohet në mënyrë të paevitueshme në fazën që vijon.

NDIHMË & MBËSHTETJE

Ne të Kazinosë Schaanwald jemi në dispozicionin tuaj! Flisni me supervisorët tanë të lojës. Këta persona do t'ju informojnë me mirëkuptim e kompetencë lidhur me mundësitë e ndryshme dhe vendet e asistencës.

Klientëve tanë u ofrohet në bashkëpunim me Shoqatën Maria Ebene, mundësia për të patur ndihmë e mbështetje kompetente në çështjet që lidhen me vartësinë nga loja.

Zyra e Konsultimit për Lojrat e Fatit / Shoqata Maria Ebene / CLEAN

Schießstätte 12 – Top 8 / 6800 Feldkirch

Tel. +43 5522 38072 / clean.feldkirch@mariaebene.at

Zyra e Konsultimit dhe Ndihmës Liechtenstein

Zyra e Shpërbimeve Sociale (Fürstentum Liechtenstein)

Postplatz 2, 9494 Schaan / Departamenti i Shërbimit

Psikiatrik-Psikologjik / Tel +423 236 72 72

Organizata Konsultimi dhe Ndihme në Zvicër

Die Dargebotene Hand

Tel. 143 / www.143.ch

Spielen ohne Sucht

www.sos-spielsucht.ch

Shërbimet Sociale Sarganserland

Konsultimi social dhe i vartësisë

Ragazerstrasse 11 / 7320 Sargans

Tel. +41 81 720 40 80 / www.sd-sargans.ch

Kazinoja Schaanwald ka të drejtë që, në raste të veçanta, pasi personeli ynë i specializuar të ketë komunikuar me një kategori të tillë klientësh, të shprehet për bllokimin e lojës. Kjo mund të bëhet kur biem dakord të vëmë re se nuk keni më nën kontroll vetëpërmbajtjen tuaj në lojë. Për shembull, kur kemi arsye të besojmë se sasia e parave që po luani tejkalon mundësitë tuaja financiare.

KËSHILLË PALËS SË TRETË

Jeni të shqetësuar për vetëpërmbajtjen e ndokujt në lojërat e fatit? Si partner jete, familjar apo mik keni mundësinë dhe keni për detyrë të bëni diçka. Mund t'i drejtoheni personalisht, me telefon apo me shkrim në çdo moment Kazinosë Schaanwald, duke tërhequr vëmendjen lidhur me ndryshimin në sjellje të një klienti, apo lidhur me ndryshimin e situatës së tij financiare për shkak të lojrave të fatit. Mos hezitoni të na kontaktoni, sepse ne bisedojmë për situatën dhe së bashku mund të gjejmë një zgjidhje.